

RELACION PËR PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA 2026-2030 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2026-2028”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i këtij projektvendimi ka si qëllim miratimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe Planit të Veprimit 2026-2028 të saj, e cila hartohet në vijim të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021 – 2025 dhe Planit të saj të Veprimit 2023-2025.

Dokumenti strategjik synon që në Republikën e Shqipërisë të vijojë sigurimi dhe garantimi i mbrojtjes, stabilitetit dhe sigurisë kombëtare përmes forcimit të institucioneve të mbrojtjes ruajtjes të rendit dhe sigurisë, menaxhimit të rrezikshmërisë dhe kërcënimeve, zhvillimit ekonomik si dhe integritetit në Bashkimin Evropian. Hartimi i Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026 – 2030 është diktuar nga nevoja për rinovimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021 – 2025, për t’iu përgjigjur sfidave të reja të krimeve që po bëhen gjithnjë e më të sofistikuar dhe ndërkombëtare. Ky dokument është hartuar për të orientuar politikën në drejtim të forcimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse për parandalimin e dukurive të tilla si kultivimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike, krimet financiare dhe pastrimi i parave, krimet kibernetike, krimet mjedisore, si dhe për të parandaluar përfshirjen e të rinjve dhe grupeve vulnerabël në aktivitete kriminale. Format moderne të krimit kërkojnë një strategji të re, që të përfshijë mjete të avancuara teknologjike, bashkëpunimin ndër-institucional dhe mekanizma të koordinuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Nisur sa më sipër, qëllimi kryesor i këtij projektvendimi është të sigurojë bashkërendimin, koordinimin dhe harmonizimin e përpjekjeve të institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese në nivel kombëtar, si dhe të rekomandimeve të partnerëve dhe organizatave ndërkombëtare që operojnë në fushën e krimit të organizuar.

Një tjetër shtysë është përafrimi me standardet e Bashkimit Evropian dhe përmbushja e kërkesave të kapitujve 23–24 në procesin e integritetit evropian të Shqipërisë.

Rritja e ndërgjegjësimit publik për pasojat e krimit dhe kërkesa për ndëshkueshmëri reale kërkojnë një qasje të re, e cila jo vetëm ndëshkon krimin por ka si qëllim dhe promovimin e kalimit të aseteve të konfiskuara në njësitë e vetëqeverisjes vendore, për t’u përdorur në projekte sociale dhe përfitime publike, duke i shërbyer komunitetit.

Në vitet e fundit, Shqipëria ka shënuar përparime të dukshme në luftën kundër krimit të organizuar, duke intensifikuar operacionet policore, përmirësuar kapacitete hetimore, si dhe duke rritur bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtar. Arrestimi i drejtuesve kryesorë të botës së krimit, çmontimi i grupeve kriminale dhe sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale të tyre janë dëshmi konkrete e këtij progresi. Lufta ndaj krimit përbën një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe është një ndër kriteret kryesore për procesin e anëtarësimit në BE. Konsolidimi i shtetit të së drejtës dhe rritja e sigurisë në vend janë të lidhura ngushtësisht me përmirësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor me aktet e BE-së, rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike në institucionet ligjzbatuese, garantimin e integritetit, përmirësimin e proceseve hetimore dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar.

Dokumenti strategjik do të ofrojë një pasqyrë të qartë të përgjigjes shtetërore në luftën kundër krimit, pasi përfshin disa komponentë, si më poshtë:

1. Krimi i organizuar;
2. Krimet e rënda (trafikimi i drogave, veprave të artit dhe trashëgimisë kulturore, kontrabandimi i imigrantëve etj.);
3. Krimet financiare dhe ekonomike;
4. Krimi kibernetik;
5. Krimet mjedisore (etj.)

Kjo strategji do të shërbejë si udhërrëfyes për mobilizimin e të gjitha strukturave për t'iu kundërpërgjigjur grupeve dhe individëve kriminalë, duke harmonizuar ndërveprimin midis qeverisë, sektorit privat, komunitetit dhe qytetarëve për këtë qëllim.

Plani i ri i Veprimit 2026-2028 synon intensifikimin e përpjekjeve të përbashkëta për goditjen dhe shkatërrimin e grupeve kriminale dhe rrjeteve të tyre. Nëpërmjet forcimit të kapaciteteve aktuale dhe krijimit të kapaciteteve të reja do të përmirësohen proceset e gjurmimit, konfiskimit dhe sekuestrimit të aseteve dhe pasurive kriminale. Në qendër të kësaj qasjeje do të jetë aftësi i institucioneve për identifikimin e të dhënave, përpunimin, analizimin dhe vlerësimin e tyre, me qëllim njohjen e strukturave kriminale dhe infiltrimin në to, duke shtuar në këtë mënyrë forcën goditëse dhe efikasitetin në luftën ndaj tyre. Plani i ri i Veprimit do të konsolidojë këto arritje dhe të vendosë një bazë të fortë për një qasje të qëndrueshme dhe të koordinuar në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Në këtë kuadër, sa më sipër ky projektvendim ka si qëllim të krijojë kushte të favorshme për parandalimin e aktiviteteve kriminale dhe ndëshkimin e të gjithë atyre që janë të përfshirë në aktivitete të paligjshme, të organizuara dhe të strukturuar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe Plan i Veprimit 2026-2028 në zbatim të saj, do të hartohet në përputhje dhe harmoni të plotë me metodologjinë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030. Konkretisht në shtyllën e parë të SKZHIE 2030 “Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë”, është parashtruar nevoja e forcimit të mëtejshëm të institucioneve efikase të vendit si bazë që siguron demokracinë, konkurrencën dhe zhvillimin ekonomik të vendit duke e përgatitur atë për anëtarësim në BE. Në këtë shtyllë është parashikuar lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit si një ndër komponentët përbërës të saj. Qëllimi strategjik në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda i parashikuar në SKZHIE 2030 është “Garantimi i një mjedisi të sigurt për zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë nga kërcënimet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke siguruar jetën e individit, sipërmarrjen e lirë dhe respektimin e ligjshmërisë në tërësi”.

Ky qëllim strategjik është i zbërthyer në dy qëllime politike si në vijim:

1. Qëllimi i Politikës 1 – Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda;
2. Qëllimi i Politikës 2 – Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë.

Lidhja e dokumentit strategjik me programin Qeverisës 2021–2025 është gjithashtu e drejtpërdrejtë, pasi ky program synon transformimin e administratës shtetërore dhe përmirësimin e shërbimeve publike përmes reformave strukturore, digjitalizimit dhe zhvillimit të infrastrukturës, duke nxitur investimet dhe inovacionin për një zhvillim ekonomik dhe social të qëndrueshëm, me orientim të fortë drejt integritetit evropian.

Një seksion kyç i programit thekson nevojën për të ndërtuar një Shqipëri të sigurt, ku institucionet e sigurisë dhe sistemi i drejtësisë punojnë së bashku për të luftuar kriminalitetin dhe për të krijuar një ambient publik ku qytetarët dhe investitorët të ndihen të mbrojtur.

Dokumenti strategjik lidhet me Kapitullin 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria për aspektet e luftës kundër krimit të organizuar, bashkëpunimit në fushën e drogave, luftës kundër krimit kibernetik, hetimeve financiare, bashkëpunimit policor.

Lufta kundër krimit të organizuar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenet 4, 82, 84 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër trafikeve të paligjshme, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenet 4 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër pastrimit të parave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenin 4 dhe 82 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Gjithashtu, në Nenet 5, 82 dhe 84 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së në fushën e luftës kundër terrorizmit. Nenet 83 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit sigurojnë

bashkëpunimin në fushën e luftës kundër drogës. Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, të parashikuara në nenet 14, 15, 34, 43 dhe 97. Bashkëpunimi në fushën e çështjeve penale është përcaktuar në Nenin 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Në lidhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), **OZHQ 16, qëllimi 16.1, 16.2 dhe 16.A, kanë si qëllim** promovimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

Qëllimi i OZHQ 16.1: Zvogëlimi i ndjeshëm kudo i të gjitha formave të dhunës dhe shkallën e vdekjeve të lidhura me to.

Qëllimi i OZHQ 16.2: T'i jepet fund abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturës ndaj fëmijëve.

Qëllimi i OZHQ 16.A: Forcimi i institucioneve kombëtare relevante, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin.

Strategjia është në harmoni dhe përmbush gjithashtu detyrimet që burojnë nga angazhimet e dokumenteve të tjerë kombëtarë strategjik si dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare si në vijim:

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030;
- Strategjia Ndërsektoriale për Sigurinë Publike dhe Planin e Veprimit 2024 – 2026;
- Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftës kundër Terrorizmit dhe planet e veprimit 2023-2025;
- Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe planin e veprimit 2021-2027;
- Strategjia e Kontrollit për Armët e Vogla e të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve dhe planin e veprimit 2019-2025;
- Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimin 2024 – 2030;
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024 – 2030;
- Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2024 – 2030 ;
- Agjenda Kombëtare e Reformave 2024 – 2027;
- Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës për Kapitullin 23 dhe 24;
- Prioritetet e Ministrit të Punëve të Brendshme;
- Marrëveshje me EUROPOL, INTERPOL;

- Konventa kundër krimit të organizuar transnacional etj.

Hartimi i kësaj strategjie është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent konsultimi ndërmjet institucioneve publike, agjencive të zbatimit të ligjit, sistemit të drejtësisë, aktorëve të shoqërisë civile, qytetarëve, grupet e interesit, organizatat e specializuara dhe institucionet publike që kanë rol në fushën e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda dhe sundimit të ligjit, ku mund të përmendim: strukturat e varësisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, AAPSK), Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Mjedisit, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Pasurive Kulturore, Shërbimi Informativ Shtetëror, Banka e Shqipërisë, Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, OJQ dhe Organizma Ndërkombëtarë (EU4LEA, ICITAP, Këshilli i Evropës, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri), media.

Këto konsultime kanë ndihmuar në identifikimin e prioriteteve kombëtare, në përmirësimin e draftit të strategjisë dhe në garantimin e një baze të gjerë konsensusi dhe mbështetje institucionale dhe nga partnerët ndërkombëtarë apo donatorët për masat e propozuara. Gjithashtu, procesi i konsultimit publik është zhvilluar në përputhje me kornizën e transparencës dhe pjesëmarrjes së parashikuar nga legjislacioni shqiptar duke mundësuar komente, sugjerime dhe rekomandime nga publiku i gjerë dhe partnerët socialë nëpërmjet platformave elektronike dhe komunikimeve zyrtare. Kjo ka garantuar jo vetëm legjitimitet demokratik, por edhe një qasje të integruar dhe praktike në hartimin e strategjisë, duke reflektuar realisht nevojat dhe sfidat aktuale të identifikuara në terren.

Në këtë kuadër, hartimi i Strategjisë së Re është mbështetur në një analizë të plotë të arritjeve dhe sukseseve të arritura gjatë implementimit të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, e cila ka shërbyer si një udhëzues i nevojshëm për vijimin e reformave të iniciuara tashmë si dhe për përcaktimin e objektivave të rinj për periudhën në vijim, të reflektuar tashmë në dokumentin e ri strategjik. Kërcënimet vijnë të mbeten kryesisht në prodhimin dhe trafikimin e drogës, trafikimin e qenieve njerëzore, trashëgimisë kulturore, krimit financiar dhe pastrimit të parave të aseteve të përfituara nga veprimtari kriminale dhe për këtë nevojitet intensifikim i përpjekjeve të organeve ligjzbatuese për përballimin e këtyre kërcënimeve.

Me qëllim të uljes së kërcënimit të krimit të organizuar dhe të krimeve të rënda, nevojitet adresimi njëkohësisht i shqetësimeve kryesore të identifikuara. Sigurisht, goditja dhe ndjekja e strukturave të krimit të organizuar, të cilat veprojnë brenda apo jashtë vendit është me rëndësi jetike për zbatimin efektiv të kësaj politike.

Një ndër prioritetet kryesore siç është goditja e fenomenit të kultivimit të lëndës së kanabisit i hap rrugë një faze tjetër më të vështirë, goditjes së grupeve kriminale, të përfshirë në organizimin dhe financimin e kwsaj veprimtarie.

Gjithashtu mbetet sfida trajtimi i fenomenit të pastrimit të parave duke pasur parasysh vlerësimin e fundit të kryer për Shqipërinë ana e FATF/Moneyval.

Një tjetër aspekt për t'u trajtuar është hetimi i krimeve kibernetike, pas organizimit strukturor të Policisë së Shtetit në vitin 2023, ku dhe u krijua Drejtoria për Hetimin e Krimit Kibernetik në Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Referuar sa më sipër, ky proces gjithëpërfshirës dhe konsultativ është themeli për zhvillimin e një strategjie të qëndrueshme dhe efektive në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke siguruar bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet institucioneve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare, si dhe duke mbështetur një mjedis të sigurt, të drejtë dhe të qëndrueshëm për qytetarët dhe shoqërinë në tërësi.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ministria e Punëve të Brendshme vlerëson se lufta kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda mbetet një nga prioritetet kryesore të identifikuar për vijimin e sigurisë të rendit publik, duke nënvizuar rëndësinë e domosdoshme për hartimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030, si dhe Planin e Veprimit 2026-2028 në zbatim të saj, për faktin se përfshin përgatitjen e një dokumenti strategjik të ri që do të sigurojë realizimin e prioritetëve qeveritare, përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare dhe zbatimin e rekomandimeve nga partnerët ndërkombëtarë për periudhën 2026-2030.

Nisur nga natyra multidimensionale dhe format komplekse të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, si dhe nga sfidat që parashtron trajtimi i tyre, është vlerësuar që krijimi i një dokumenti të ri strategjik është opsioni më i mirë për t'u përgjigjur rrezikut të krimit të organizuar.

Evoluimi i aktiviteteve kriminale, i nxitur nga zhvillimet teknologjike dhe i ndikuar nga lëvizjet e fundit migratore nga rajoni MENA (Middle East North Africa) kërkon garantimin e një qasje gjithëpërfshirëse ndërinstitutionale shtetërore, në bashkëpunim dhe me aktorët jositetërorë e cila mund të sigurohet vetëm nëpërmjet një dokumenti të ri strategjik të hartuar.

Mbështetja e këtij opsioni vjen edhe për shkaqet e mëposhtme:

- Shkëputja e komponentit të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore i cili do të zhvillohet në një dokument strategjik me plan veprimi të dedikuar për këtë fushë;
- Nevoja për përfshirjen e një qasje strategjike për rekuperimin e aseteve të konfiskuara dhe shërbimin forensik;

- Nevoja për ngritjen në nivel strategjik të rritjes së kapaciteteve të hetimit të krimit kibernetik i cili është në nivel të një dokumenti strategjik sektorial afati i të cilit përfundon në vitin 2025;
- Nevoja për përfshirjen në mënyrë më të dedikuar të qasjes strategjike për parandalimin e krimeve mjedisore.

Strategjia e re do të hartohet në harmoni me prioritetet e Bashkimit Evropian në luftën kundër krimit të organizuar 2026 – 2030 duke bërë të mundur unifikimin e qëndrimit strategjik të Shqipërisë me partnerët evropianë.

Dokumenti i ri strategjik do të mundësojë identifikimin dhe parandalimin e veprimtarive kriminale në mënyrë të koordinuar dhe efektive, duke përfshirë të gjitha institucionet ligjzbatuese dhe aktorët relevantë. Gjithashtu, ky dokument do të ndihmojë në krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm për hetimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin e rrjeteve kriminale, rekuperimin e aseteve kriminale si dhe në ndërgjegjësimin e publikut për rreziqet që paraqet krimi i organizuar për shoqërinë dhe zhvillimin e vendit.

Gjithashtu, strategjia e re do të ndihmojë në parashikimin e aspekteve të forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, shkëmbimit të informacionit dhe koordinimin me agjencitë partnere, çka është thelbësore në trajtimin e formave të krimit që shtrihen përtej kufijve kombëtarë.

Në këtë mënyrë, strategjia kontribuon në rritjen e besimit të publikut dhe të partnerëve ndërkombëtarë ndaj kapaciteteve të shtetit për të garantuar drejtësi dhe siguri.

Përzgjedhja e treguesve është një hap i rëndësishëm në procesin e monitorimit dhe vlerësimit. Treguesit janë komponentë esenciale për vlerësimin e efektivitetit të masave dhe aktiviteteve të strategjisë dhe matjen e progresit drejt objektivave strategjike. Në përzgjedhjen e treguesve do t'i jepet përparësi realizueshmërisë dhe mundësisë së matjes efektive të tyre. Treguesit e përzgjedhur do të jenë të lidhur me kontekstin dhe objektivat specifike të strategjisë, të realizueshëm në lidhje me mbledhjen e të dhënave, dhe të matshëm në mënyrë objektive dhe cilësore. Treguesit do të zgjidhen në konsultim me insitucionet raportuese, pasi angazhimi i tyre në procesin e përzgjedhjes së treguesve do të ndihmojë në përvetësimin e elementeve të Strategjisë nga institucionet dhe në përfshirjen e këndvështrimeve dhe prioritetëve të ndryshme

Në mënyrë të përmbledhur, strategjia e re do të përmbajë tregues lidhur me:

- Indeksin e efektivitetit në luftën kundër narkotikëve;
- Sasinë e lëndëve narkotike të identifikuar/sekuestruar;
- Indeksin e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave dhe krimeve ekonomiko - financiare;
- Indeksin e efektivitetit në goditjen e strukturave kriminale;

- Operacionet policore kombëtare/ndërkombëtare të kryera me qëllim goditjen e grupeve kriminale;
- Masat parandaluese me karakter ekonomik dhe pasuror;
- Numrin e personave të kapur në kërkim ndërkombëtar;
- Indeksi i ripërdorimit të pasurive të konfiskuara për qëllime sociale;
- Hetimet e kryera në fushën e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Ky dokument do të ketë një impakt ndërsektorial ku implementimi dhe monitorimi i Strategjisë së re do të angazhojë një sërë institucionesh shtetërore dhe një numër të madh kapacitetesh njerëzore, për shkak të gamës së gjerë të fushave që do të mbulojë.

Masat në zbatim të planeve të veprimit në fushën e krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme, kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, duhet të kryhen nga disa struktura në bashkëpunim.

Vëmendje e shtuar në këtë strategji do t'i dedikohet parandalimit dhe luftës ndaj krimeve mjedisore. Për arsye të qarta grupet e strukturuar kriminale janë më pak të interesuara për një zhvillim të tillë të qëndrueshëm dhe me anë të investimeve të tyre kanë si objektiv rritjen e përfitimeve nëpërmjet aktiviteteve kriminale. Një fushë tjetër ku individë dhe grupe kriminale janë shfaqur aktiv është shfrytëzimi i burimeve natyrore, njëra prej të cilave është industria e lëndëve të para. Shqipëria ka pësuar shpyllëzime masive dhe përkeqësime si rezultat i prerjeve të paligjshme në të cilat kanë kontribuar grupe lokale të krimit të organizuar dhe zyrtarë të korruptuar. Gjithashtu, raportet e policisë kanë treguar se krimet mjedisore kanë pësuar rritje në periudhën 2023 – 2025.

Për sa më sipër, kjo strategji do t'i japë prioritet më të madh ruajtjes së mjedisit, duke kaluar në disa filtra burimet e të ardhurave që do përdoren për investimet në zona ku impakti mjedisor është i madh.

Gjithashtu, duke shtuar vëmendjen dhe prezencën në zonat e mbrojtura mjedisore, do të garantohet mbrojtja e tyre, si dhe e burimeve të tyre natyrore e biologjike. Kjo mund të realizohet vetëm nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë nëpërmjet institucioneve. Impakti mjedisor do të trajtohet në kuadër të luftimit të krimeve mjedisore dhe ruajtjes së florës e faunës në territor, goftë në zonat e mbrojtura ose ato ku ndodhin shkeljet mjedisore.

Kjo strategji do të ketë një impakt të drejtpërdrejtë në ekonominë e vendit, pasi do të krijojë një mjedis më të sigurt për sektorin privat dhe investimet e huaja.

Megjithëse, mungon një studim i thelluar për vlerësimin e dëmit ekonomik dhe sektorët e prekur si pasojë e aktivitetit të grupeve të strukturuar kriminale në Shqipëri, sipas Indeksit Global të Krimit të Organizuar, të realizuar në vitin 2023, Shqipëria renditet e 15 në Evropë (44 në total) dhe e 87 në botë (193 në total) me notën 5.17 në shkallën e vlerësimit 1 – 10 (1 – mirë dhe 10 shumë dobët)

Ekzistenca e aseteve të paligjshme të përfituara përmes veprimtarisë kriminale vështirëson shumë aftësinë e bizneseve të ndershme të jenë të konkurrueshëm në treg me çmime dhe cilësi.

Po ashtu, pastrimi i parave dëmton drejtpërdrejtë institucionet e sektorit financiar që janë thelbësore për rritjen ekonomike, nxit krimin dhe korrupsionin, si dhe ngadalëson zhvillimin ekonomik të një vendi. Nëpërmjet skemave të pastrimit të parasë krijohet për më tepër një rreth vicioz, pasi ri-investohet në grupet kriminale dhe financimin e kultivimit të drogës, duke fuqizuar krimin, si dhe veprimtaritë e tyre.

Përballimi i këtyre problematikave do të sillte një klimë pozitive në aspektin ekonomik në vend, pasi do të rriste sigurinë e bizneseve në veprimtarinë e tyre, si dhe do të tërhiqte investime të reja, të huaja dhe vendase. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj strategjie do të luftohet krimi dhe grupet kriminale sipas parimit **“Follow the Money”**, me qëllim eliminimin e burimeve financiare që furnizojnë grupet kriminale, duke kufizuar në këtë mënyrë fuqinë e tyre vepruese.

Efektet e krimit të organizuar dhe komponentët e ndryshëm kriminalë shtrihen edhe në rrafshin social të një vendi, duke ndikuar negativisht në aspektet sociale dhe etike të një shoqërie, vlerat morale dhe normat shoqërore, integritetin dhe etikën, sferën private, perceptimin e sigurisë publike, etj.

Sondazhet tregojnë se krimi i organizuar perceptohet nga qytetarët si kërcënimi i dytë më i madh pas korrupsionit për sigurinë në vend. Referuar këtyre sondazheve të kryera në vitet e mëparshme, rezulton se ka rritje të numrit të qytetarëve në perceptimin e krimit të organizuar si kërcënim.

Kjo strategji synon rritjen e besimit të shoqërisë në institucionet shtetërore, uljen e ndikimit social të krimit, duke luftuar fillimisht imazhin e shembujve dhe aktiviteteve kriminale që shpesh herë perceptohen pozitivisht tek qytetarët dhe shihen si alternativa më e lehtë.

Gjithashtu, përmes ripërdorimit efektiv të aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara kriminale për qëllime sociale dhe në ndihmë të viktimave të krimit, impakti do të jetë i ndjeshëm në rehabilitimin dhe fuqizimin e tyre por do të shërbejë edhe si një formë e parandalimit të krimit të organizuar dhe kriminalitetit në përgjithësi duke forcuar kapacitetet e institucioneve, të shoqërisë civile, subjekteve private, grupeve vulnerabël me fokus te të rinjtë dhe gratë për t'u angazhuar dhe përfshirë në aktivitete që nxisin, promovojnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre për të parandaluar krimin e organizuar dhe pavarësinë ekonomike.

Ripërdorimi i aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara nga veprimtaria kriminale për qëllime sociale përfaqëson një qasje novatore dhe të drejtë që mund të sjellë ndryshim të prekshëm në shoqëri. Këto asete, në vend që të mbeten të bllokuara apo të degradohen si pasuri të braktisura, mund të rikthehen në funksion të komunitetit dhe të kontribuojnë ndjeshëm në rehabilitimin, fuqizimin dhe integrimin e viktimave të krimit dhe grupeve vulnerabël.

Konkretisht, këto pasuri mund të shndërrohen në qendra komunitare, hapësira edukimi dhe trajnimi profesional, strehë të përkohshme për viktimat e dhunës, si dhe struktura të tjera që ofrojnë mbështetje psiko-sociale dhe juridike. Kjo nismë jo vetëm që ofron ndihmë të drejtpërdrejtë për individët në nevojë, por gjithashtu krijon një efekt simbolik dhe praktik në parandalimin e krimit të organizuar, duke transformuar frytet e paligjshmërisë në mjete për drejtësi dhe zhvillim.

Ripërdorimi social i aseteve kriminale krijon gjithashtu mundësi për forcimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore dhe të shoqërisë civile për të bashkëpunuar në mënyrë më efektive. Kjo qasje përfshin:

- Angazhimin e të rinjve dhe grave në programe edukative dhe aktivitete sociale, duke kontribuar në përfshirjen e tyre në aktivitete që forcojnë vetëbesimin dhe autonominë ekonomike;
- Mbështetjen e nismave të sektorit privat që ndihmojnë në krijimin e vendeve të punës për personat në nevojë apo që janë rikthyer nga situata të vështira sociale si dhuna apo varfëria;
- Krijimin e programeve ndërgjegjëse dhe trajnime për zyrtarët publikë, mësuesit, psikologët dhe punonjësit socialë për t'u përfshirë në menaxhimin efektiv dhe etik të këtyre aseteve;
- Krijimin e mekanizmave të monitorimit dhe transparencës, duke përfshirë komunitetin në procesin e identifikimit dhe përdorimit të aseteve të konfiskuara për të garantuar që ndikimi i tyre është real dhe i matshëm.

Në këtë mënyrë, pasuritë që dikur ishin mjete të veprimtarisë kriminale shndërrohen në instrumente për ndërtimin e qëndrueshmërisë sociale dhe ekonomike duke rritur perceptimin pozitiv të mbizotërimit të shtetit të së drejtës.

Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me institucionet e tjera relevante, është e anazhuar për të forcuar mekanizmat e zbatimit të ligjit dhe për të garantuar që politikat e sigurisë të jenë sa më efektive. Po ashtu, një element kyç i këtij procesi është angazhimi ndërkombëtar, përmes bashkëpunimit të ngushtë me partnerët ndërkombëtar, si Europol, Interpol dhe agjencitë e tjera të sigurisë globale. Kjo, mundëson një qasje më të koordinuar dhe më të fuqishme ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar transnacional dhe krimeve të rënda që ndikojnë në sigurinë e brëndshme dhe të jashtme.

Në këtë kuadër plani i veprimit, referuar edhe ekspertizave të mëparshme parashikon masa të cilat duhet të realizohen sipas afateve të përcaktuara në dokument, me qëllim realizimin në kohë dhe më cilësi të qëllimeve strategjike, si parandalimi i krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, ndjekja penale dhe goditja e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, duke synuar të arrihen duke zbatuar masat nga institucionet përgjegjëse brenda afateve kohore të përcaktuara.

Planit i Veprimit 2026-2028, për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, synon të përmirësojë më tej rezultatet e arritura deri më tani, duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe agjencive të ndryshme, si dhe të parterëve ndërkombëtar. Ky plan ka për qëllim të sigurojë një koordinim të ngushtë me të gjitha institucionet qendrore dhe vendore, duke integruar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave për të luftuar krimin e organizuar dhe krimet e rënda. Kjo do të arrihet përmes një serie masash dhe iniciativash që synojnë forcimin e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë.

Një nga objektivat kryesore të këtij plani është realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimin për parandalimin e krimit të organizuar, ku do të përfshihen jo vetëm institucionet qendrore dhe vendore, por edhe shoqëria civile, media, biznesi dhe aktorët e tjerë. Aktivitetet do të realizohen përmes videomaterialeve, organizimit të leksioneve dhe seminareve të hapura në institucione arsimore publike dhe private, me qëllim edukimin dhe informimin e publikut në lidhje me rreziqet dhe pasojat e krimit të organizuar.

Një tjetër komponent i rëndësishëm i planit është trajnimi i stafit të specializuar në luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore. Këto trajnime do të fokusohen në forcimin e kapaciteteve të stafit për koordinimin e aktiviteteve dhe ndjekjen e procedurave të përditësuara, si dhe për shkëmbimin e përvojave dhe ideve të reja që mund të kontribuojnë në luftën kundër krimeve kulturore. Kjo risi do të mundësojë një trajtim më të integruar dhe më të avancuar të këtyre krimeve.

Në vijim, zhvillimi i takimeve ndërgjegjëse mbi procedurat e kalimit të pronave të konfiskuara nga aktiviteti kriminal tek institucionet qendrore dhe vendore është një tjetër aspekt i rëndësishëm i këtij planit. Këto takime do të synojnë informimin dhe ndihmën në përmirësimin e procedurave të kalimit të pronave, duke mundësuar një përdorim më të drejtë dhe më të dobishëm të këtyre pasurive të konfiskuara. Përdorimi i pasurive të konfiskuara për krijimin e mundësive për zhvillimin e projekteve që ndihmojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe shërbimeve për komunitetin do të kontribuoni në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe forcimin e lidhjeve me qytetarët.

Në këtë mënyrë, Planit i Veprimit 2026-2028, për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të sjellë një koordinim të ngushtë dhe të qëndrueshëm mes aktorëve të ndryshëm, duke synuar një qasje të integruar dhe të qëndrueshme në luftën kundër krimit dhe përmirësimin e kushteve sociale dhe administrative.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Dokumentet strategjike të paraqitura janë në harmoni me rendin juridik të brendshëm. Strategjia është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe veçanërisht nenin 100 të saj, sipas të cilit ndër të tjera përcaktohet se, “*Këshilli i Ministrave përcakton drejtorimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore*”, vendimin nr. 509, datë 25.09.2025, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Brendshme*”, si dhe është hartuar në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara apo konventa, ku Republika e Shqipërisë ka aderuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektvendim nuk përafron në vetvete një akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian, por do të shërbejë si instrument për adresimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian për përafrimin me *acquis communautaire* për fushën e rendit dhe sigurisë publike.

Dokumenti strategjik lidhet drejtëpërdrejtë me kapitujt kyç të procesit të integritimit evropian:

Kapitulli 23- Gjyqësori dhe të drejtat themelore, Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë, Legjislacioni i rishikuar dhe udhëzime përkatëse për të siguruar përafrimin me *acquis të BE-së* për rikuperimin e aseteve deri në vitin 2024.

Rritje e bashkëpunimit, përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, në çështjet e sekuestrimit dhe konfiskimit përfundimtar të produkteve të veprës penale të korrupsionit nëpërmjet krijimit të Zyrës së Rikuperimit të Pasurive si njësi speciale e Policisë së Shtetit deri në vitin 2024.

Kapitulli 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria, për çështjet e luftës kundër krimit të organizuar dhe kundër terrorizmit, bashkëpunimit në fushën e drogave, luftës kundër krimit kibernetik, hetimeve financiare, bashkëpunimit policor.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Plani i Veprimit 2026-2028 përmban 3 qëllime politike si më poshtë:

1. Parandalimi i krimit të organizuar dhe krimeve të rënda;
2. Ndjekja penale dhe goditja e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda;
3. Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar.

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është siguri i një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm për zhvillimin e vendit dhe shoqërisë, duke mbrojtur individët dhe strukturat shoqërore nga kërcënimet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Nëpërmjet këtij plani veprimi, synohet krijimi i kushteve që do të garantojnë mbrojtjen e jetës së individëve, mbështetje për zhvillimin e sipërmarrjes së lirë dhe respektimin e ligjshmërisë në tërësi. Kjo është një nevojë

thelbësore për forcimin e rendit dhe sigurisë në nivelin kombëtar dhe për krijimin e një klime besimi të qëndrueshme për qytetarët dhe institucionet.

Ky plan është i strukturuar në tre drejtime kryesore, duke kombinuar masat parandaluese, duke adresuar çdo fazë të veprës penale, nga parandalimi deri në ndjekjen dhe dënimin e krimeve, si dhe më e rëndësishmja bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar Secili nga këto drejtime mbështetet nga disa objektiva specifike dhe masa të detajuara, të cilat kanë për qëllim realizimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetje për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit.

Qëllimi i Politikës I: “Parandalimi i krimit të organizuar dhe krimeve të rënda” përmban 5 objektiva specifik si më poshtë:

Objektivi specifik 1.1: Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit për parandalimin e krimit të organizuar, me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë.

Objektivi specifik 1.2: Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël.

Objektivi specifik 1.3: Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t’iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar.

Objektivi specifik 1.4: Rritja e profesionalizmit.

Objektivi specifik 1.5: Dobësimi i motivit financiar në përfshirje në krimit të organizuar

Qëllimi i Politikës II: “Ndjekja penale dhe goditja e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda” përmban 9 objektiva specifike si më poshtë:

Objektivi specifik 2.1: Krijimi i një mjedisi të sigurt për shoqërinë përmes uljes së ofertës dhe mundësive për përdorim të paligjshëm të narkotikëve.

Objektivi specifik 2.2: Goditja e trafikeve të paligjshme.

Objektivi specifik 2.3: Përmirësimi i efikasitetit në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar, pastrimit të parave, korrupsionit dhe të ardhurave nga krimi.

Objektivi specifik 2.4: Hetimi i krimeve kibernetike.

Objektivi specifik 2.5: Krijimi i një qasje strategjike për një shërbim forensik të akredituar që garanton integritetin e provës në sistemin e drejtësisë.

Objektivi specifik 2.6: Qasje strategjike mbi procesin e identifikimit, gjurmimit, konfiskimit të aseteve me prejardhje kriminale dhe ripërdorimit të tyre.

Objektivi specifik 2.7: Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i drejtuesve dhe anëtarëve të strukturave kriminale.

Objektivi specifik 2.8: Forcimi i parandalimit, zbulimit dhe ndëshkimit të krimit mjedisor duke zbuluar grupet e organizuara në aktivitete kriminale ndaj mjedisit, si dhe uljen e ndjeshme të rasteve të ndotjes së qëllimshme, prerjes ilegale të pyjeve dhe trafikimit të mbetjeve të rrezikshme si dhe shkatërrimit të shtretërve të lumenjve.

Objektivi specifik 2.9: Kapja e personave në kërkim ndërkombëtar.

Qëllimi i Politikës III: “Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar” përmban 2 objektiva specifike si më poshtë:

Objektivi specifik 3.1: Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar.

Objektivi specifik 3.2: Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti sipas fushave të përfshira në SKKOKR 2024-2030, sipas përgjegjësisë të përcaktuara në Planin e Veprimit 2026 – 2028.

VIII. MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Projektakti është hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Draft Strategjia Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2024-2030 është hartuar dhe koordinuar nga Ministria e Punëve të Brendshme me kontributin e Grupit të Punës të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 96, datë 17.06.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe të Planit të Veprimit 2026-2028”.

Projektvendimi dhe relacioni shoqërues do të përcillen nëpërmjet sistemit e-aktet pranë:

- Ministrisë së Drejtësisë;
- Ministrisë së Mbrojtjes;
- Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit;
- Ministrisë Ekonomisë dhe Inovacionit;
- Ministrisë së Arsimit;
- Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministrisë së Mjedisit;
- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale;
- Ministria së Evropës dhe Punët e Jashtme;
- Ministrisë së Financave;
- Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin;
- Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

Projektvendimi dhe relacioni shoqërues do të përcillen me shkresë zyrtare për mendim pranë:

- Shkollës së Magjistraturës;
- Prokurorisë së Përgjithshme;
- Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

- Byrosë Kombëtare të Hetimit;
- Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;
- Inspektoratit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;
- Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike;
- Bankës së Shqipërisë;
- Shërbimit Informativ të Shtetit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE:

Efektet financiare përllogariten nga çdo institucion bazuar në implementimin e aktiviteteve të masave përkatëse që janë të parashikuara në Planin e Veprimit 2026-2028 të kësaj Strategjie. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara, si dhe me buxhetim nga donatorë për zbatimin e Planit të Veprimit 2026-2028 të Strategjisë së Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, të ndryshuar, në mënyrë të detajuar, si më poshtë:

Në vijim paraqitet shpërndarja e kostove treguese dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030. Kostimi i Strategjisë është realizuar duke u mbështetur në metodologjinë dhe praktikën e planifikimit buxhetor, ndërsa vlerësimi i kostove indikative është mbështetur në objektivat e përcaktuar si dhe në masat e aktiviteteve të identifikuar për secilin aktivitet. Përllogaritjet buxhetore janë bërë duke përdorur instrumentin e rekomanduar nga IPSIS, të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e **Planit të Veprimit 2026-2028, të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030** është **55,091,694,337 Lekë**.

Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 93.1 lekë për 1 Euro.

Tabela 1: *Kostot e përgjithshme, burimet e financimit dhe hendeku financiar gjatë periudhës kohore 2026-2030.*

Qëllimi i Politikave	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale	Kostot e Planifikuara	Kostot e Planifikuara	Hendeku Financiar
		2026-2028	PBA 2026-2028	PBA 2026-2028	2023-2025
			Buxheti	Donatorët	
Qëllimi i Politikës I	Korente	12,681,193,149	12,675,193,149	6,000,000	0

	Kapitale	468,287,000	468,287,000	0	
Qëllimi i Politikës II	Korente	7,798,399,066	7,796,164,066	2,235,000	0
	Kapitale	34,198,521,998	3,941,821,998	30,256,700,000	
Qëllimi i Politikës III	Korente	945,293,124	945,293,124	0	0
	Kapitale	0	0	0	
TOTALI [Leke]		56,091,694,337	25,826,759,337	30,264,935,000	0
TOTALI [Euro] 1 euro 93.1 Leke		602,488,661	277,408,801	325,079,860	0

Efektet financiare janë përlogaritur për të gjithë periudhën e zbatimit të strategjisë 2026-2030, duke mbajtur në konsideratë aktivitetet e parashikuar në planin e veprimit 2026-2028 dhe dokumentin strategjik. Efektet financiare parashikohen të përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e masave, nga buxhete të donatorëve dhe institucioneve të tjera që janë ngarkuar për zbatimin e masave.

Procesi i kostimit u mbështet në konsultimin e dokumenteve të tjerë kombëtarë, përfshirë këtu Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2028-2030 dhe konsultimet me të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e planit, si dhe në kostot historike nga zbatimi i planit pararendës.

Plani i veprimit shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i cili mbështetet nga detajimi i hollësishëm i shpenzimeve për çdo aktivitet. Kostimi i strategjisë dhe planit të veprimit është realizuar në bazë të metodologjive dhe praktikave së planifikimit buxhetor, duke përdorur instrumentet e rekomanduar nga IPSIS.


Grafiku 1: *Financimi i strategjisë do të realizohet nga disa burime duke përmendur këtu buxhetin e shtetit (46%) dhe financim të huaj (54%). Hendeku financiar është 0%.*

	LEK		EURO
Kostot Totale të PV	56,091,694,337	%	602.488,661

PBA 2026-2028	25,826,759,337	46	277,408,801
Financimi i Huaj	30,264,935,000	54	325,079,860
Hendek financiar 2026-2028	0	0	0

Kosto Korente	21,424,885,339	38	220,492,861
Kosto kapitale	34,666,808,998	62	372,360,999
Total kosto	56,091,694,337	%	602.488,661

Grafiku nr. 2: Paraqitja grafike e kostove të planit të veprimit të strategjisë duke evidentuar ndarjen e shpenzimeve me financim nga Programi Buxhetor Afatmesëm dhe me financim të huaj



Grafiku nr. 3: Paraqitja grafike e natyrës së kostove ekonomike të strategjisë dhe të planit të veprimit duke evidentuar ndarjen në kosto korente dhe kosto kapitale




Kostot korente zënë rreth 38% të shpenzimeve totale, ndërsa kostot kapitale zënë rreth 62%.

Për masat të planit që janë të pambuluara financiarisht për periudhën 2026-2028, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor, si dhe do të negociojnë me donatorë të ndryshëm për t'i bashkëfinancuar disa aktivitete.

Strategjia është fokusuar kryesisht në ndjekjen penale dhe goditjen e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, e cila evidentohet edhe në paraqitjen e mëposhtme grafike ku qëllimi i politikës II zë peshën më të lartë specifike në totalin e kostos së planit të veprimit të kësaj strategjie.

Grafiku nr. 4: Paraqitja grafike e ndarjes së kostove sipas qëllimeve të politikave



PROPOZUESI

MINISTRI

ALBANA KOÇIU